

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“NIL Engineering” sh.p.k

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, sot më datë **07.03.2025**, ortaku i vetem si poshtë shënuar:

1. **Z. Bledar Spahiu**, shtetas shqiptar, lindur më 04.10.1979, në Kolesjan, Kukës, banues në Tiranë, mbajtës i leternjoftimit me Nr: 037167702, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

ka vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1. Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“NIL Engineering” sh.p.k**, në vijim referuar si **“Shoqëria”**.

NENI 2

BAZA LIGJORE

- 2.1. *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2. Kjo *Shoqëri* fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 3

SELIA

- 3.1 Selia kryesore e aktivitetit të *Shoqërisë* është në adresën: Rruga **“Gjon Krisili, Ndertesa 64”**, Tiranë, Shqipëri.



NENI 4 OBJEKTI

4.1. Objekti kryesor i veprimtarisë së *Shoqërisë* përfshin sa më poshtë vijon:

Shoqëria ofron një gamë të gjerë shërbimesh inxhinierike dhe ndërtimore, duke mbuluar të gjitha aspektet e studimit, projektimit, zbatimit dhe konsulencës në fusha të ndryshme të ndërtimit civil dhe industrial.

- I. Inxhinieri dhe Ndërtim
 - a. Studim, projektim dhe zbatim në të gjitha fushat e ndërtimit.
 - b. Punime ndërtimore dhe rikonstruksione në objekte civile dhe industriale.
 - c. Gërmime, ndërtim dhe rehabilitim të strukturave ekzistuese.
- II. Impiante Teknologjike dhe Energjitike
 - a. Projektim dhe instalim i impianteve teknologjike, termike, hidrike dhe të ventilimit (ftohje-ngrohje, kondicionim).
 - b. Punime elektrike për objekte civile dhe industriale.
 - c. Projektim dhe zbatim për energjinë e rinovueshme (solar, erë, hidro).
 - d. Ndërtim dhe mirëmbajtje të impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, nënshtacioneve, kabinave të transformatorëve dhe linjave të shpërndarjes së energjisë.
- III. Infrastrukturë dhe Rrugë
 - a. Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugëve, autostradave, mbikalimeve, hekurudhave, tramvajeve, metrove dhe pistave aeroportuale.
 - b. Rikonstruksioni i veprave të artit dhe montimi i konstruksioneve metalike.
- IV. Arkitekturë, Dizajn dhe Mobilim
 - a. Konsulencë dhe shërbime në fushën e dizajnit, mobilimit dhe arredimit.
 - b. Prodhim, furnizim dhe montim i mobiljeve për objekte industriale dhe rezidenciale.
- V. Telekomunikacion dhe Teknologji
 - a. Ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.
 - b. Projektim dhe instalim i sistemeve elektrike dhe të telekomunikacionit.
- VI. Ndërtime dhe Restaurime të Specializuara
 - a. Ndërtimi i objekteve turistike dhe objekteve të kultit.
 - b. Restaurimi dhe mirëmbajtja e godinave civile dhe industriale.
 - c. Veshja e fasadave dhe izolimi termik i ndërtesave.
- VII. Shërbime të Integruara dhe Konsulencë



- a. Studim, projektim, konsulencë dhe sipërmarrje zbatuese për projekte me fonde publike dhe private.
- b. Asistencë teknike dhe mbështetje profesionale në fushën e arkitekturës dhe inxhinierisë.
- c. Vlerësim dhe shitje të pasurive të patundshme.

VIII. Import-Eksport dhe Tregti

- a. Furnizim dhe vendosje të materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike.
- b. Import-eksport i materialeve të ndërtimit, mobilje, makinerive, pajisjeve dhe impianteve elektrike dhe industriale
- c. Tregtim i pajisjeve elektro-shtëpiake, elektronike dhe telekomunikacionit

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet ndihmës dhe të nevojshëm që është në përputhje me këtë objekt aktiviteti, duke mos kundërshtuar ligjet shqiptare në fuqi.

**NENI 5
KOHËZGJATJA**

- 5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

**NENI 6
KAPITALI THEMELTAR**

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i pashlyer nga Ortaku Themelues i shoqërisë përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, në raport me kontributin e dhënë nga ortaku në shoqëri.
- 6.3. Pjesët e kapitalit zotërohen nga ortaku i vetëm:
- a) **Z. Bledar Spahiu**, zotëron 100 % (një përqind përqind) të kapitalit të shoqërisë ose 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 100.000 Lek (njëqind mijë).

**NENI 7
TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**

- 7.1. Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.



NENI 8
ADMINISTRIMI

- 8.1. Emërohet Administrator i *Shoqërisë z.* Bledar Spahiu, shtetas shqiptar, lindur më 04.10.1979, në Kolesjan, Kukës, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr: 037167702, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar..
- 8.2. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë.
- 8.3. Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe ka të drejtë t’i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.
- 8.4. Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

NENI 9
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1. Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2. Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

ORTAKU I VETËM

Bledar Spahiu

BLENDAR SPAHIU

